



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranverorë

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 77

Prishtinë, më 29 prill 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Şinik, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lavdim Krasniqi dhe Suzana Pllana – IGJK, Lumnije Murati – ZPRK, Sahit Dragaj –PPK, Nafije Kuqi dhe Shaban Kelmendi – Sindikata e Pensionisteve të Kosovës, Blerta Bejtullahu -EUSR/EU, Arbëresha Loxha – Grupi për studime juridike dhe politike, Besnik Ramadani - KDI, Leonora Berbatovci – RTK, Artan Canhasi – EULEX, Elvis Feka..., Petrit Hysaj – OSBE, Visar Smajlaj – ekspert, Lejla Selimi – OSBE, Gurjeta Zeka, Mirhane Morina, Burbuqe Berisha, Saranda Kelmendi, Xheneta Sopjani dhe Labinot Lepashtica – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi , kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.03.2013;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 191 për Blegtorinë;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 131 për skemat pensionale të financuara nga shteti;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-179 për transportin rrugor;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi në pika të ndryshme të futet edhe shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin me amendamentet e propozuara nga grupi punues.

Albulena Haxhiu – Ajo ishte kundër që si pikë rendit të ditës të përfshihet edhe Projektligji për Avokatin. Ishte e mendimit se duhet të mbahet dëgjim publik me grupet e interesit, sepse është çështje e rëndësishme në mënyrë që të paraqesin vërejtjet e tyre. Ne, si subjekt politik, lidhur me këtë Projektligj i kemi paraqitur vërejtjet e shumta dhe nuk ka mundësi që brenda dy orëve të bëhen tërë ato amendamente, nuk janë inkorporuar amendamentet e Odës së avokatëve që i janë adresuar Kuvendit. Po ashtu, as administrata nuk ka qenë e informuar lidhur me ato amendamente dhe mendoj se duhet marrë kohë shtesë për organizim të dëgjimeve publike.

Armend Zemaj – Tha se si grup punues kemi filluar me vonë dhe prezent ishin Albulena Haxhiu, Behar Selimi dhe Halit Krasniqi. Albulena e ka parë të arsyeshme që për shkak të kohës së shkurtër të mos vazhdojë pjesëmarrjen në grup punues. Ne i kemi marrë në shqyrtim të gjitha amendamentet e propozuara nga Oda e Avokateve edhe komentet e tjera që kanë arritur nga profesorë të fakultetit juridik dhe ekspertë të tjerë dhe kemi propozuar 15 amendamente për të cilat le të vendos Komisioni se si do ta procedojë më tutje.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.03.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25.03.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 131 për skemat pensionale të financuara nga shteti

Kryetari – Paraqiti vërejtje në amendamentin 6 dhe vlerësoi se duhet të hiqen fjalët “deri me 1 korrik 2014 “, sepse me ligjin për të drejtat e ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, përkatësisht me nenin 3, paragrafi 4, nenin 9, paragrafi 2 dhe nenin 25, është përcaktuar afati për nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë çështjen e stazhit pensional për kategoritë e personave të përmendur, në amendamentin 6, i propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Po ashtu vlerësoi se është me rëndësi që rekomandimet e dala nga seanca plenare e datave 11 dhe 18 prill 2013, lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptarë të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri në vitin shkollor 1999, të jetë pjesë e këtij ligji.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 04/L- 131 për skemat pensionale, të financuara nga shteti dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç amendamentit 6.
2. Ky amendament është në mospajtim me dispozitat e ligjit për të drejtat e ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, andaj i rekomandohet Komisionit Funksional që këtë amendament ta harmonizojë me dispozitat e këtij ligji (nenet 3 par. 4, 9 par. 2 dhe neni 25)
3. I sugjerohet Komisionit Funksional që në këtë amendament fjalët **“deri me 1 korrik 2014”**, të hiqen.
4. I sugjerohet Komisionit Funksional që të veprojë në pajtim me rekomandimet e dala nga seanca plenare e datave 11 dhe 18 prill 2013, lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri në vitin shkollor 1999, që edhe kjo kategori e punëtorëve të jetë pjesë e këtij ligji.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012

Lavdim Krasniqi – Tha se raporti përshinë aktivitetin e organeve drejtuese, aktivitetet që realizohen në kuadër të programeve, si dhe raportet për aktivitete të tjera. Ai foli programet trajnuese që përfshinë programin e trajnimit të vazhdueshëm, programet e trajnimit fillestar për trajnimin për avancim dhe aktivitete të tjera. Mirëpo, për dallim nga vitet e tjera të mëparshme, vitin e kaluar kemi pasur një fokus në trajnimet e karakterit të specializuar për arsye të përgatitjes të gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatimin e ligjeve të reja që kanë ndërruar strukturën e sistemit gjyqësor dhe prokuroria. Nëse krahasojmë vitet e mëparshme, vitin i kaluar ka shënuar një ndryshim në përmbajtjen e programit. Përveç trajnimeve janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera. Instituti gjyqësor ka një bashkëpunim të mirë me institucionet trajnuese në rajon dhe me gjerë, kemi bashkëpunim me donatorë të shumtë. Numri i pjesëmarrësve ka qenë i njëjtë, zakonisht në trajnim marrin pjesë të gjithë gjyqtarët dhe prokuroret, shumica prej tyre marrin pjesë 2 deri në 5 herë gjatë vitit. Gjatë vitit 2012 trajnimi nuk ka qenë obligues, por nga 1 janari është bërë i tillë. Çështja e trajnimit fillestar është çështje në vete. Ne kemi filluar më 4 gjenerata dhe 141 kandidatë kanë kaluar programin fillestar, shumica prej tyre janë emëruar gjyqtarë dhe prokurorë, kurse një pjesë janë në pritje të shpalljeve të reja. Në vazhdim foli për mbështetjen e donatorëve. Ne jemi në përgatitje të funksionalizimit të bibliotekës dhe qendrës për hulumtime, të cilat do të ndihmonin një qasje më të mirë në burime ligjore. I gjithë ky aktivitet është zhvilluar me një buxhet prej 512.000 €. Vitin e kaluar kishim një numër të trajnuesve ndërkombëtarë, projektet që janë mbështetur prej donatorëve kryesisht. Ne vlerësojmë

se çështja e trajnimeve të vazhdueshme duhet të ndërroj qasjen për arsye se konsiderohet përgatitje paraprake për gjyqtarët dhe prokurorët është me e preferuar sesa pas emërimit. Gjendja që kemi në sistem ka nevojë për shumë angazhim dhe instituti gjyqësor nuk mund i vetëm ta ndryshojë këtë nivel të kapaciteteve.

Albulena Haxhiu – Ai kishte vërejtje lidhur me hulumtimin ligjor dhe gjyqësor duke pasur parasysh faktin se Institutit duhet t'i identifikojë problemet dhe dukurit negative rreth zbatimit të ligjit dhe sadopak t'i orientojnë planet për trajnimin dhe aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këtu flitet për doracaket e prezantuar në raport, mirëpo, mendoj se më shumë është dashur të bëhen hulumtime dhe punime shkencore edhe përmbledhja e praktikës gjyqësore vlerësoi që kjo qasje është shpërfillur. Çështja tjetër ka të bëjë me sfidat e institutit gjyqësor të Kosovës dhe ndryshimet e shpeshta ligjore, mirëpo nuk e kam lexuar se si është përballuar kjo sfidë. Në raport nuk mund të arrihet kurrfarë përfundimi, nëse ka pasur koordinim me shoqatën e gjyqtareve, prokurorëve, ose me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Lidhur me vizitat studimore të zhvilluara, nga raporti nuk mund të përfundohet se cilat janë përfitimet e institutit dhe përfituesve të saj dhe cilat janë veprimet konkrete të ndërruara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe si janë zbatuar ato. Gjithashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk raportoi për ndonjë vlerësim vetanak për punën e tij. Sa i përket raportit në tërësi unë e vlerësoi si një raport të drejtë dhe do e përkrahu.

Halit Krasniqi – Sa i përket raportit theksoi se ishte një raport shumë i kompletuar në të gjithë kapitujt e tij. Ishte një angazhim fasciuës, trajnimi i gjyqtarëve, prokurorëve, mësimi në distancë, programi i bibliotekës, buxheti i kufizuar, natyrshëm janë impresionuese. Në të gjithë kapitujt kishte një përkushtim të stafit të institutit gjyqësor dhe drejtorit të tij. Ai kërkoi sqarim pse nuk ka pasur presion tek institucionet e Kosovës që të rritet buxheti, sepse me këtë buxhet kaq të vogël të bëhet një punë kaq voluminoze dhe të bëhen vizita studimore është për kompliment.

Haki Demolli – Tha se dua të ndërlidhem te vërejtja e parafolësit. Në kohën kur isha ministër i Drejtësisë kisha disa takime me drejtorin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku njëra nga çështjet ka qenë pikërisht buxheti. Ndihma e këtij Komisioni është e nevojshme që të këtë lëvizje buxhetore. Raportin e vlerësoi si mjaft të kompletuar, ngase pasqyron shumë të dhëna për të gjitha aktivitetet duke filluar nga trajnimet, vizitat studimore, bibliotekat etj. Ai kërkoi mendimin e drejtorit të IGJK-së përse pas te gjitha studimeve dhe trajnimeve për gjykatësit, prapëseprapë ekziston një perceptim te qytetarët se nuk janë të kënaqur me performancën e tyre. Në praktikë ekziston një perceptim se gjyqësori nuk është efikas. Në vazhdim ai pyeti edhe për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me kodin penal dhe kodin e procedurës penale të cilat e dimë se kanë hyrë në fuqi në janar të këtij lidhur me këtë sa gjyqtarë kanë qenë dhe për çfarë janë trajnuar?

Armend Zemaj – Ai duke folur për punën dhe angazhimin e IGJK-së tha se ne aspektin e përgjithshëm nuk besoj se mund të kemi vërejtje se sa trajtohen gjyqtarët dhe prokurorët, por sa i bartin ato njohuri në punët që iu parashtrihen. E dimë gjendjen edhe të gjyqësorit edhe të prokurorisë dhe vlerësimi im nuk është aq pozitiv edhe pse ka tendenca të përmirësimit. Ai ishte i mendimit që lista e trajnuesve me emër dhe mbiemër të gjyqtarëve, prokurorëve, profesorëve,

duhet t'i bashkëngjiten raportit, sepse nuk e kemi një shumë të vogël që paguhen për këto shërbime të trajnimit. Është me rendësi të dihet shërbimet intelektuale kush i ofron, cilët janë ata njerëz. Ai kërkoi që të vihen në pah të metat e gjyqtarëve kur dihet se shumë prej tyre edhe punojnë si ligjërues në universitete private. Esenciale është trajnimi dhe edukimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për çështjen e trajnimit kundër korrupsionit. Kërkoi sqarim sa i përket trajnimit jashtë vendit sidomos mënyra e financimit, se a është nga donatorët, apo është nga ana e Institutit. Në fund pyeti se sa po ju mundësoni studenteve të fakultetit juridik të bëjnë praktik në institucionin tuaj?

Arsim Bajrami – Pyeti nëse ka ndonjë mekanizëm në institut për matjen e kualitetit të mësimdhënies që ofrojnë ligjëruesit?

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit ju përgjigj drejtori Institutit Gjyqësor të Kosovës, z. Lavdim Krasniqi dhe pas debatit kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 191 për Blegtorinë

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin për blegtorin dhe kërkoi nga anëtarët, nëse kane vërejtje për raportin.

Kryetari , konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 04/L- 191 për Blegtorinë dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-179 për transportin rrugor

Kryetari – Tha se përmbajtja e amendamentit 43, fjalët “**Dhe, për motoçikleta 1 +1 (një plus një) ulëse por vetëm brenda qytetit**”, nuk ka bazë për procedim të mëtejshëm dhe është në kundërshtim me nenin 2, të Projektligjit dhe nenin 57.4 të Rregullores së Kuvendit.

Armend Zemaj – Tha se nuk ka ndonjë vërejtje tjetër përveç amendamentit 5 pasi që vlerësoi se është në kundërshtim me Ligjin për konkurrencën.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji 04/L-179, për transportin rrugor dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç amendamenteve 5 dhe 43.
2. Amendamenti 5 është i pa nevojshëm, sepse nuk jep sqarimet e duhura në përkufizimin lidhur me atë se çka nënkupton “menaxher transporti”.
3. I sugjerohet Komisionit FunkSIONAL, që në amendamentin 43, fjalët “**Dhe, për motoçikleta 1+1 (një plus një) ulëse por vetëm brenda qytetit**” të hiqen sepse janë të pa nevojshme dhe nuk janë objekt i Projektligjit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Behar Selimi - Propozoi që për shqyrtimin e këtij Projektligji të formohet një grup punues dhe të bëjmë përpjekje që ta harmonizojmë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu, ishte kundër këtij propozimi dhe ripërsëriti mendimin se ky Projektligj duhet t'i kthehet Qeverisë për shkak se është kundër Kushtetues.

Në momentin e votimit të pranishëm ishin 8 deputetë.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Behar Selimi për formimin e një grupi punues, lidhur me këtë Komisioni ishte i ndarë dhe me 4 vota “për” dhe 4 vota “kundër”. Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion nuk e miratoi propozimin.

8. Te ndryshme

a. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin

Armend Zemaj - Në emër të kryesuesit të grupit punues i arsyetoi amendamentet e propozuara dhe i ftoi të votojnë anëtarët e Komisionit.

Kryetari – Ngriti shqetësimin e tij për raportin e ligjit për Avokatin dhe Ligjit për dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlerësoi se ka dispozita që bien ndesh njëra me tjetrën dhe cili ligj do të ketë epërsi kolizioni.

Kryetari, konstatoi se Komision për Legjislacion me një votë kundër njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion dhe i njëjti procedohet për shqyrtim të mëtejme në komisionet kryesore.

Mbledhja përfundoi ne orën 13.40

E përgatiti
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi